



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Departamenti Teknik
Drejtoria e Procedurave, Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore

Adresa: Rr.Durresit,Laprake, Tirane, Shqiperi

Tel. 24 39 20- 21

Nr. 13993 Prot,

Tiranë, më 06.10.2010

U D H E Z I M

Nr 02 , dt. 06.10.2010

Per
perdorimin e magazinimit te perkohshem ne sistemin Asycuda World

Me qellim percaktimin dhe unifikimin e rregullave mbi perdorimin e magazinimit te perkohshme duke shfrytezuar sistemin infnomatik Asycuda World

Bazuar ne nenet 75-78 te Ligjit nr. 8449, dt. 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise" si dhe neneve 112-117 te VKM nr. 205, dt. 13.04.1999, "Per Dispozitat Zbatuese te Kodit Doganor"

U D H E Z O J :

1). Mbajtja e regjistrave:

1. Mbeshtetur ne nenet 75-78 te Ligjit nr. 8449, dt. 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise" si dhe neneve 112-117 te VKM nr. 205, dt. 13.04.1999, "Per Dispozitat Zbatuese te Kodit Doganor", ne magazinimin e perkohshem mbahen regjistrat perkates.
2. Referuar mundesive qe ofron sistemi kompjuterik Asycuda World, keto regjistra do te mbahen elektronikisht ne sistem.
3. Me "Regjistra te hyrjes" do te konsiderohet teresia e manifesteve te regjistruara ne sistem.

II). Manifesti dhe procedurat ne lidhje me administrimin e tij:

1. "Manifest" eshte teresia e ngarkesave qe ka nje mjet i cili depoziton mallra ne magazinim te perkohshem. Nje manifest perbehet nga nje ose me shume ngarkesa, te cilet per efekt te ketij udhezimi do t'e quhen (konsiderohen) se perbehet nga "Billa".
2. Manifesti mund te hidhet ne sistem ne menyre manuale, duke hedhur çdo Bill te tij apo mund te ngarkohet ne forme elektronike duke respektuar ne menyre rigoroze formatin e te dhenave qe kerkon Asycuda World.
3. Me ngarkimin ne system te manifestit dhe berjen te vlefshme te kohes mallrat konsiderohen se jane futur ne magazinim te perkohshem dhe mbajtési i autorizimit eshte pergjegjes per keto mallra.
4. Ne rastet kur ambjentet e magazinimit te perkohshem jane ne nje distance nga zyra doganore, qe ne momentin e ngarkimit te manifestit ne sistem ato konsiderohen ne magazinim te perkohshem dhe ne se kryhet inventar prane ambjenteve nga dogana do te meret parasysh koha e nevojshme per mbritjen e tyre ne magazine.
5. Manifesti pasi eshte vleresuar ne sistem printohet nje kopje dhe i jepet transportuesit per te justifikuar levizjen e mallrave nga pika e hyrjes (kufiri i teritorit doganor shqiptar) deri ne ambjentet e magazinimit te perkohshem.
6. Çdo deklarate doganore duhet patjeter te lidhet me manifestin dhe numrin e Billes ne menyre qe te behet shkarkimi automatik i mallrave ne magazinim te perkohshem. Ky shkarkim do te konsiderohet si regjister i daljes nga magazinimi i perkohshem.

III) Administruesi i magazines dhe procedura e kontrollit:

1. Administruesi i magazinimit te perkohshem eshte i detyruar te mos nxjere prej tij asnje mall qe nuk ka nje deklarate doganore te miratuar.
2. Per ato deklarata qe ka nevojte te kryhet kontroll fizik dogana cakton nje orar te pershtatshem gjate te cilit do te jete prane ambjenteve te Magazinimit te perkohshem per te kryer kontrollin fizik dhe clirimin e mallrave.
3. Gjate ketij orari do te behet edhe kontrolli i ngarkesave me vlere te paperfillshme qe nuk kane nevojte te mbulohen nga nje deklarate doganore.
4. Pas ketij kontrolli doganieri kontrollues do te beje mbylljen manuale te Billave ne sistem per ngarkesat me vlere te paperfillshme, vetem pas kesaj ato jane te lira te dalin nga magazinimi i perkohshem.

IV) Raste specifike ne transportin ajror:

Per transportin ajror pa rene ndesh me nenin 257 te Kodit Doganor;

1. Ne rast se per shkaqe transporti, konstatohen mungesa te dergesave krahasuar me ato te manifestit, administratori i magazines i paraqet kerkese me shkrim Deges Doganore per eleminimin e ketyre dergesave nga manifesti duke paraqitur dhe konfirmimet e transportuesit per keto mosperputhje. Kryetari i Deges Doganore referuar dokumentacionit ben miratim me shkrim per dergesat e pambyllura. Billat perkatese mbyllen manualisht nga punonjesi i ngarkuar per mbylljen manuale te manifestit.
2. Ne rast se per shkaqe transporti, konstatohen prezenca e mallrave te derguara gabimisht (te pa pasqyruara ne manifest), Administratori i magazines i paraqet kerkese Deges se Doganes, te ciles i bashkangjiti dokumentat e nevojshme shpjeguese. Kjo kerkese shqyrtohet dhe miratohet nga Kryetari i Deges dhe pasi jane verifikuar (spontuar) manualisht nga manifesti keto dergesa çlirohen per te shkuar ne destinacion.

V). Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere

Flamur GJYMISHKA

DREJTOR I PERGJITHSHEM